



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 1431 / Prot.

Patos, më 18 / 06 / 2025

PROJEKTVENDIM

Nr. 28, datë 18 / 06 / 2025

MIRATOHET
KRYETARI
Fation Duro

PËR MIRATIMIN E DHËNIES SË NDIHMËS FINANCIARE NGA “FONDI I KUSHTËZUAR I BUXHETIT TË SHTETIT PËR MBROJTJEN CIVILE” NË VLERËN 45,000 (DYZETË E PESË MIJË) LEKË PËR Z. FERKO XHELAIJ BANESA E TË CILIT ËSHTË DËMTUAR NGA RËNIA E ZJARRIT, LAGJJA “1MAJ”.

KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Në mbështetje të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 329, datë 16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, i ndryshuar pika 3.1 shkronja “a” të V.K.M-së nr. 414, dt. 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” Planit Kombëtar për Emergjencat Civile të miratuar me VKM nr. 835, datë 3.12.2004, si dhe kërkesës së z. Ferko Xhelaj me nr. 1731 prot., datë 04.06.2025, i kërkojmë Këshillit të Bashkisë:

1. Të miratojë dhënien e ndihmës financiare z. Ferko Xhelaj për rehabilitimin e dëmeve të shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesë me vlerë 45,000 (dyzetë e pesë mijë) lekë.
2. Vlera e kësaj ndihme do të mbulohet nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile 2025, **Kodi i produktit 91707 AB** “Shtetas të ndihmuar banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme”

EKIPI I PROGRAMIT TË MENAXHIMIT

Të Mbrojtjes nga Zjarri, shpëtimit dhe Mbrojtjes Civile.
Drejtues të Programit

Ermenita **MICI**

Alket **HALIMI**

ANËTARË

Arben **SHPËRDHEJA**

Arlind **RUSTO**

Florian **TORO**

Juriste
Nurkë **Hazizaj**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA E PATOS

DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 1731 / Prot.

Patos, më 18/06 /2025

RELACION

PËR MIRATIMIN E DHËNIES SË NDIHMËS FINANCIARE NGA “FONDI I KUSHTËZUAR I BUXHETIT TË SHETIT PËR MBROJTJEN CIVILE” NË VLERËN 45,000 (DYZETË E PESË MIJË) LEKË PËR Z. FERKO XHELAI BANESA E TË CILIT ËSHTË DËMTUAR NGA RËNIA E ZJARRIT, LAGJJA “1MAJ”.

Z. Ferko Xhelai ka paraqitur kërkesën me nr.1731 prot., datë 04.06.2025, për verifikimin e dëmeve të shkaktuara në banesë në lagjen “1 Maj” nga rënia e zjarrit dhe për ndihmë financiare për rehabilitimin e saj. Për verifikimin e kërkesës së qytetarit është ngritur komisioni me urdhërin nr.118, nr.1731/1 prot., datë 10.06.2025 i përbër nga :

- | | |
|---------------------|---------|
| a. Ermenita Mici | Kryetar |
| b. Arben Shpërdheja | Anëtar |
| c. Ervis Ruçaj | Anëtar |
| d. Gazmira Plesati | Anëtar |
| e. Andi Kola | Anëtar |

Komisioni pasi bëri verifikimin në vend të dëmeve të shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesën e z. Ferko Xhelai mbajti procesverbalin me nr.1731/2 prot., datë 10.06.2025. Nga procesverbali i verifikimit në vend rezulton se janë djegur :

Vetrat durali 11 m², 1(një) frigorifer dhe 1(një) aspirator.

U hartuar edhe preventivi për punimet që duhet të kryhen në banesë në vlerën 128,848.24 (njëqindë enjëzetë e tetë mijë e tetëqindë edyzetë e tetë pikë njëzetë e katër) lekë, referuar edhe “Vërtetimit për rënie zjarri” nr. 1 të datës 30.05.2025 lëshuar nga MZSH Patos që vërteton rënien e zjarrit. Në bazë të V.K.M-së nr. 329, datë 16.5.2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” të dëmtuarit i jepet ndihmë financiare 50% e vlerës.

Bazuar në V.K.M-në nr. 414, dt. 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” (i ndryshuar) pika 3.1 shkronja “a” me qëllim për të ndihmuar qytetarin Z. Ferko

Xhelaj, banesa e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit, t'i jepet një ndihmë financiare në vlerën 45,000 (dyzetë e pesë mijë) lekë.


Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohet:

Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Projekteve dhe Emergjencave Civile.

EKIPI I PROGRAMIT TË MENAXHIMIT
Të Mbrojtjes nga Zjarri, shpëtimit dhe Mbrojtjes Civile.

Drejtues të Programit

Ermenita **MICI**



Alket **HALIMI**



ANËTARË

Arben **SHPËRDHEJA**



Arlind **RUSTO**

Florian **TORO**



KRYETARI
Fation Duro

